



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.760/22

GJYKATA KOMERCIALE-Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit N.T.P “S...” Sh.p.k, me nr, NRB; ....., të cilën e përfaqëson A.P, ndaj debitorit N.SH.T “V...” me nr.NRB; ....., me pronarë P.Q nga Gjakova, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm-Devizioni Civil, PPP.nr.205/20 i datës; 06.05.2021, me datë 30.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si e pasafatshme ankesa e kreditorit, N.T.P “S...” Sh.p.k, me nr, NRB; ....., të cilën e përfaqëson A.P Gjakovë, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, PPP.nr.205/20, i datës, 06.05.2021.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr. 205/20, i datës 06.05.2021, ka vendosur si në vijim: I. Pranohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit N.SH.T “V...”, me pronarë P.Q. II. Anulohet Urdhri për Përmbarim i përmbaruesit privat Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë, P.nr.697/20 i datës 16.10.2020, dhe prishen të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra nga i njëjti.”

Kundër këtij aktvendimi kreditori N.T.P “S...” Sh.p.k,me nr, NRB; ....., të cilën e përfaqëson A.P Gjakovë me datë; 25.05.2021 ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa dhe të anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm-Devizioni Civil PPP.nr.205/20 dt.06.05.2021,dhe lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, si gjykatë e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Ankesa e kreditorit është e pa afatshme.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar afatshmërinë e ankesës së ushtruar nga ana e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të ankimuar të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me shenjën PPP.nr.205/2020, të datës 06.05.2021, ka konstatuar se ankesa është paraqitur pas kalimit të afatit kohor ligjor të dhënë në këshillën juridike të aktvendimit të ankimuar prej 7 ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit në dorëzim të të njëjtit aktvendim nga kreditori.

Tek një përfundim i tillë kjo gjykatë vjen për faktin se me shikim në fletë kthesën e cila gjendet si dëshmi në shkresat e lëndës konstatohet se kreditori aktvendimin e ankimuar e ka pranuar në mënyrë të rregullt me datën 17.05.2021 (ditë e hane), ndërsa ankesën kundër të njëjtit aktvendim, e ka dorëzuar në gjykatë me datë 25.05.2021(ditë e marte), që vërtetohet nga vula e pranimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, e cila është vendosur në ankesën e dorëzuar tek e njëjta gjykatë.

Afati kohor ligjor për ushtrim të ankesës ka qenë afati prej 7 ditësh siç është dhënë edhe në këshillën juridike, i cili ligjërisht ka filluar të rrjedhë nga dita e nesërme prej kur kreditori e ka pranuar aktvendimin e ankimuar, që në rastin konkret i bie të ketë filluar nga data 18.05.2021, e ku me shikim në kalendarin mujor – maj për vitin 2021, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e ankesës – duke marrë afatin e dhënë në këshillën juridike ka qenë data 24.05.2021(ditë e hane), datë kjo kur edhe ka skaduar afati kohor ligjor prej 7 ditësh i dhënë në këshillën juridike. Nga kjo rezulton se kreditori ka paraqitur ankesë 1 ditë me vonesë, pra jashtë afatit kohor.

Afatet kohore të përcaktuara me ligj, janë të pandryshueshme dhe nuk mund të zgjaten apo shkurtohen as me vendim të gjykatës e as me marrëveshjen e palëve. Afati ligjor ka karakter prekluziv, sepse veprimi procedural i lidhur për afatin ligjor nuk mund të kryhet pas skadimit të tij.

Dhoma e Shkallës së Dytë, në kuptim të rrethanave të paraqitura më lart gjen se ankesa është e pasafatshme pasi që me dispozitën e nenit 77 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, përcaktohet se: *“Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit”*, si dhe në bazë të nenit 186 paragrafi 2 të LPK-së është e paraparë se *“Ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”*, ndërsa me dispozitën e nenit 196 përcaktohet se: *“Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në nenin 186 të LPK-së”*.

Kështu në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë provë me të cilën do të konfirmohej se ankesa është dorëzuar në ndonjë datë tjetër, apo me anë të postës por e njëjta është dorëzuar drejtpërdrejt në gjykatë e shkallës së parë me çka dhe u vërtetua nga vula e protokolimit të gjykatës, prandaj nga arsyet e mësipërme, Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi pasi që gjeti se ankesa e debitorëve është e pa afatshme, të cilën kjo gjykatë e hedhë poshtë në pajtim me nenin 77 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, si dhe nenin 186 paragrafi 2, 196 dhe 209 pika (a) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE - DHOMA E SHKALLËS SË DYTË  
K.DH.SH.II.nr.760/2022, me datë,30.08.2022

Gjyqtarja

Franciska Zhitija-Ymeri